



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010 dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjes dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Kryeqytetit,

th ë r r e t

mbledhjen e **parë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **23.1.2025** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën nr. 37 (kati II) të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së njëmbëdhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim-vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026;
3. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;
4. Propozimvendimi për hartimin e Planit të hollësishëm rregullues Çagllavicë;
5. Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm Zona Ekonomike;
6. Propozim-vendimi për përkrahje financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar;
7. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031;
8. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor dhe caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të kultit - xhamisë në fshatin Orloviq, të komunës së Prishtinës;
9. Propozim-vendimi për miratimin e projektregullores për subvencionet e Komunës së Prishtinës;

10. Propozim-vendimi për miratimin e kërkesës së përfaqësuesve të lagjes “Kodra e Diellit II”, për themelimin e komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e Aktvendimit mbi eksproprijim, nr. 07. nr. 465-25/85, të datës 8 korrik 1985;
11. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-6873/25, më 14.1.2025

KRYESUES I KOMITETIT

Fehmi Kripina



Faqe 2 nga 2

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://ëëë.pristina-komuna.org>